

KONTRATË SHITJE KUOTASH

Sot, më 03/06/2019 hartohet dhe nënshkruhet kjo kontratë nga dhe ndërmjet palëve të mëposhtme:

SHITËSI: LEONARD PAPAS, I biri Kristo, lindur në Kucove, më 01/07/1973, dhe banues Tirane, ne Blv BAjram Curri, kompleksi Amfora, shk 1 ap 30, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me leternjoftimin Nr.032688796 dhe Nr. Personal H30701078L

BLERËSAT: GENTIANO BERHANI, I biri I Avdyl, lindur në Kucove, Berat, më 26/10/1972 dhe banues ne Tirane, „Rr”Muhamet Gjollesha” pallati 4 p 11, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Nr. Personal H21026138C

ALTIN TROQE, I biri I Lame, lindur në Tragjas, më 16/11/1972 dhe banues ne Tirane „RR” Sami Frasheri, pallati Vega shpk shk 1, ap 11, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me leternjoftimin Nr.033491455 dhe Nr. Personal H20916052G

Kushte të përgjithshme

- A. Shoqëria „**OXHAKU**” shpk është nje shoqëri me pergjegjesi të kufizuar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me NUIS_L81610021T. Kjo shoqëri ka për objekt të veprimtarisë
- Restorant, Bar Kafe.
- B. Shoqëria zotëron të gjitha licencat, autorizimet dhe lejet përkatëse të lëshuara nga autoritetet kompetente shqiptare për te zhvilluar objektin e saj te veprimtarisë.

ALTIN TROQE

Leonard Papas

Gentiano Berhani

Shitësi është ortak I shoqërisë "OXHAKU" shpk, duke zotëruar 50.5(pesedhjetë pike pese) % te kapitalit

D. Shitësi dëshiron t'i shesë Blerësave 50.5 kuota dmth 50.5 % te kapitalit që zotëron në shoqërinë "OXHAKU "shpk.

E. Blerësi 1: z. Gentiano Berhani është i interesuar te bleje 50 kuota dmth 50 % te kapitalit që Shitësi zotëron në kapitalin e shoqërisë "OXHAKU "shpk

Blerësi 2: z. Altin Troqe është i interesuar te bleje 0.5 kuota dmth 0.5 % te kapitalit që Shitësi zotëron në kapitalin e shoqërisë "OXHAKU "shpk

F. Në përputhje me nenin 73 "Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave" shkronja b, pika 1, te ligjit nr.9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" (i ndryshuar), nenin 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, hartohet kjo kontrate e shitjes së kuotave me kushtet si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti

Shitja dhe Blerja e Kuotave


Me anë të kësaj kontrate, Shitësi i kalon Blerësave **z.Gentiano Berhani** titullin e pronësisë, të parënduar me barrë, të **50 kuota dmth 50 % te kapitalit** që zotëron në kapitalin e shoqërisë "OXHAKU "shpk dhe **z. Altin Troqe** titullin e pronësisë, të parënduar me barrë, të **0.5 kuota**

dmth 0.5 % te kapitalit

1.1 Të gjitha të drejtat e lidhura me kuotat në fjalë ndjekin kuotat dhe kalojnë gjithashtu në pronësi të Blerësave.

ALTIN TROQE


Leonard Papis


Gentiano Berhani


Kalimi i Pronësisë së Ligjshme mbi Kuotat

1.2 Blerësat do të bëhen zotërues me të drejta të plota i kuotave të blera në kapitalin e shoqërisë "**OXHAKU "shpk**", menjëherë, me nënshkrimin e kësaj kontrate nga të dyja palët.

Neni 2**Çmimi dhe Pagesa**

Çmimi i plote i shitjes që Blerësi : **z.Gentiano Berhani** do t'i paguajë Shitësit për shitjen e Kuotave është i barabartë me **50 lek kurse z.Altin Troqe** do t'i paguajë Shitësit për shitjen e Kuotave është i barabartë me **0.5 lek** . Çmimi i shitjes do të paguhet nga Blerësi me lekë në dorë.

- 2.1 Në Datën e Nënshkrimit të kësaj kontrate, Blerësi **z.Gentiano Berhani** do të jete pronari me të drejta të plota i **50 kuota dmth 50% te kapitalit** te blere kurse **z.Altin Troqe** do te jete pronari me te drejta te plota i **0.5 kuota dmth 0.5% te kapitalit**
- 2.2 Kalimi i Kuotave nga Shitësi tek Blerësi dhe çdo dokument shoqërues do të regjistrohen nga administratori i Shoqërisë ose nga i autorizuari i tij në Qendrën Kombëtare te Regjistrimit.

Neni 3**Deklarimet dhe Garancitë e Shitësit**


Shitësi deklaron dhe garanton se:

3.1 Statusi i Shoqërisë


Shoqëria është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më 10/04/2018 me numër unik identifikimi NUIS L81610021T. Shoqëria është e organizuar në mënyrë të rregullt, ekziston në mënyrë të vlefshme dhe nuk është subjekt i procedurave të falimentimit apo likuidimit sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

3.2 Kuotat e parënduara me Barrë

Faqe

ALTIN TROQE


Leonard Papis


3
 z. Berhani




Kuotat përfaqësojnë 50.5% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, janë të lira nga çdo Barrë dhe nuk ka asnjë marrëveshje, për të krijuar apo rënduar me Barrë asnjë nga Kuotat.

3.3 Pronari i ligjshëm

Shitësi deklaron dhe garanton se ai është pronari i ligjshëm i kuotave që shiten dhe gëzon të drejtën të lidhë këtë Kontratë dhe t'i kalojë Blerësave Kuotat objekt të kësaj Kontrate.

3.4 Përputhshmëria me ligjin

Shoqëria kryen dhe ka kryer aktivitetet tregtar, nga data e themelimit, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.

Neni 4

TË NDRYSHME

- 4.1 Amendamentet: Kjo Kontratë mund të ndryshohet vetëm me një marrëveshje me shkrim të të dyja palëve.
- 4.2 Pavlefshmëria: Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Kontrate është e pavlefshme, kjo pavlefshmëri nuk prek vlefshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj kontrate. Kushti i pavlefshëm në këtë rast, do të zëvendësohet me një të vlefshëm, i cili do t'i përkoj sa më shumë të jetë e mundur qëllimeve të palëve.
- 4.3 Ligji i zbatuar: Kjo Kontratë bazohet në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr.9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar.
- 4.4 Mosmarrëveshjet: Çdo mosmarrëveshje që mund dhe/ose rrjedh nga interpretimi, zbatimi, kryerja, shkelja ose përfundimi i kësaj Kontrate, do të zgjidhet nga Gjykata kompetente.
- 4.5 Gjuha e kontratës: Kjo kontratë është hartuar në 3 kopje origjinale në gjuhën Shqipe, nga nje kopje për secilën palë dhe një kopje për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Agim TROSH

Leonard Papis

gjerhami

 4

Palët pasi lexuan këtë Kontratë dhe janë dakort me përmbajtjen e saj, me vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë nënshkruajnë si më poshtë.

Albania

PALËT

SHITËSI

Leonard Papas

Leonard Papas



BLERËSAT

Gentiano Berhani

Gentiano Berhani

Altin Troqe

Altin Troqe